



Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pr. nuar me dt.	10.02.2020
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-41



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"UKSHIN HOTI" PRIZREN**

**KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY**

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT "UKSHIN HOTI" PRIZREN

DHE

KOMUNËS SË DRAGASHIT

Neni 1

Marrëveshja e Bashkëpunimit (në tekstin e mëtejme Marrëveshje) lidhet mes Komunës së Dragashit, e përfaqësuar nga Kryetari z. Shaban Shabani dhe Universitetit "Ukshin HOTI" i Prizrenit, përfaqësuar nga Rektori Prof. Asoc. Dr. Ismet Temaj.

Neni 2

Qëllimi i kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit është të përcaktojë kushtet e bashkëpunimit në mes të dy institucioneve për interesin reciprok.

Neni 3

Komuna e Dragashit dhe Universiteti "Ukshin HOTI" i Prizrenit pajtohen që për interesa të përbashkëta të asistojnë, promovojnë, përkrahin dhe ngrisin nivelin e bashkëpunimit reciprok në mes të tyre, në funksion të zhvillimit të përgjithshëm edukativ, social dhe ekonomik, dhe ngritjen profesionale të studentëve të UPZ-së.

Neni 4

Komuna e Dragashit dhe Universiteti "Ukshin HOTI" i Prizrenit së bashku do të kontribuojnë në drejtimin të zhvillimit, përkrahjes dhe promovimit të sektorit edukativ dhe profesional, ofrimin e shërbimeve përkatëse për këtë universitet, gjenerimin e punësimit dhe zvogëlimin e papunësisë. Në këtë aspekt, Universiteti i Prizrenit do t'iu ofrojë ndihmë shkencore-profesionale Komunës së Dragashit me shërbimet e veta.

Neni 5

Komuna e Dragashit dhe Universiteti "Ukshin HOTI" i Prizrenit pajtohen që në përparim të propozimeve dhe realizimit të projekteve të përbashkëta, që kanë të bëjnë me përmirësimin e ambientit ekonomik dhe social në Dragash, hartimin e analizave ekonomike, në mënyrë të rregullt të paraqesin ofrimin e përbashkët dhe të këmbëjnë informatat e domosdoshme për implementimin e projekteve.

Neni 6

Komuna e Dragashit do të pranojnë në baza mujore një numër të studentëve të Universitetit "Ukshin HOTI" të Prizrenit për të bërë praktikën profesionale nëpër zyrat e Komunës dhe institucioneve vartëse.

Neni 7

Komuna e Dragashit do të angazhohet që të ofrojë bursa për studentët më të dalluar të UPZ dhe me gjendje të rënduar ekonomike, përfshirë edhe familjet e dëshmorëve.

Neni 8

Komuna e Dragashit dhe Universiteti "Ukshin HOTI" pajtohen që për nevoja të tyre të shkëmbejnë ekspertë dhe përvojat e tyre në fushat e caktuara, që kanë kapacitete dy palët.

Neni 9

Komuna e Dragashit dhe Universiteti "Ukshin HOTI" pajtohen për Shfrytëzimin e institucioneve dhe hapësirave komunale për studentët, si: Bibliotekës Komunale, Qendra Sportive, fushave sportive, institucionet kulturore komunale, etj.;

Neni 11

Komuna e Dragashit dhe Universiteti "Ukshin HOTI" pajtohen që të bashkëpunojnë gjatë procesit të hartimit të planeve dhe dokumenteve strategjike të dy palëve.

Neni 12

Marrëveshja ka afat vlefshmërie për periudhe 5(pesë) vjeçare të bashkëpunimit me mundësi vazhdimi, plotësim ndryshimi me pajtimin e dy palëve.

Neni 14


Marrëveshja e bashkëpunimit është e nënshkruar në dy kopje në gjuhën shqipe dhe dy kopje në gjuhën angleze. Në rast të mospërputhjes, vlen kopja në gjuhën shqipe.

Kjo marrëveshje hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Përfaqësuar nga:

Rektori:

Prof. Asoc. Dr. Ismet TEMAJ



Prizren, Shkurt 2020

Kryetari i Komunës:

z. Shaban Shabanaj

